

Tiranë, më 3.10.2024

Njoftim për shtyp

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 757, datë 9.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Shqarri, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me shumicë votash, vendosi:

- 1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 757, datë 9.4.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Erjon Shqarri.*
- 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.*

U shpall sot, në Tiranë, më datë 3.10.2024.

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.